



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr. 210-8498 /2018
Klinë, me 14.12.2018

Duke u bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare me 04.06.2008, nr.28/2010, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e MMPH-së per ndalimin e ndezjes se fishekzjarrëve, kryetari i Komunës së Klinës, me dt.14.12.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për

Ndalimin e përdorimit dhe shitjes se paautorizuar te mjeteve piroteknike

1. **NDALOHET**, ndezja dhe përdorimi i fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike ne hapësirat publike, përkatësisht tregje, rruge, sheshe dhe zona te banuara, si dhe shitja e tyre nga persona dhe vende te paautorizuara.
2. Përjashtim nga ndalesa, behet me datën 24.12.2018 nga ora 19:00 deri ne orën 00:00, si dhe datën 31.12.2018 nga ora 23:00 deri 00:30 te datës 01.01.2019, por përdorimi i tyre te behet ne mënyrë te organizuar dhe kontrolluar.
3. Ndaj personave te cilët veprojnë ne kundërshtim me ketë ndalesë, do te ndërmerren masat sanksionuese ne përputhje me dispozitat e Ligjit per Përdorim Civil te Eksploziveve, nr.04/L-022 si dhe Ligjit per Kundërvajtjet, nr.05/L-087, si dhe aktet tjera nënligjore.
4. **OBLIGOHET**, Drejtoria e Inspektoratit, qe ne bashkëpunim me Policinë e Kosovës- Stacioni Policor ne Klinë, te ndërmerr te gjitha masat e nevojshme ndaj shkelësve eventual te kësaj ndalesë.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit te tij nga Kryetari i Komunës.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Inspektoratit;
- Stacioni Policor në Klinë;
- 1 kopje ne tabelën e shpalljeve
- Ekzekutivi, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

